

Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI

**TRIBUNALI NDËRKOMBËTAR PËR NDJEKJEN PENALE TË PERSONAVE  
PËRGJEGJËS PËR SHKELJE TË RËNDA TË SË DREJTËS HUMANITARE  
NDËRKOMBËTARE TË KRYERA NË TERRITORIN E ISH-JUGOSLLAVISË  
PREJ VITIT 1991**

**DEKLARATA E DËSHMITARIT**

**TË DHËNA MBI DËSHMITARIN:**

**Mbiemri:** KRASNIQI

**Emri:** Cufë

**Nofka/Alias:**

**Emri i babait:** Sokol

**Emri i nënës:** Nushe

**Datëlindja:** 24.03.1959

**Gjinia:** mashkull

**Vendlindja:** fshati Vranoc, Komuna e Pejës

**Origjina etnike:** shqiptar i Kosovës

**Feja:** islame

**Profesioni i tanishëm:** oficer policie në Stacionin e Policisë, Pejë

**Profesioni i mëparshëm:** oficer policie në Shërbimin policor jugosllav

**Gjuha (gjuhët) e folura:** shqip, serbo-kroatisht, pak anglisht dhe frengjisht

**Gjuha (gjuhët) e shkruara:** shqip, serbo-kroatisht

Nënshkruar/inicialet:

1

të tjerë të pranishëm: nënshkrim

Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI

### DEKLARATA E DËSHMITARIT

1. Jam i martuar dhe kam gjashtë fëmijë. Shtëpinë e kam në Pejë, prej ku kam ardhur tani, por jam me punë në Shkollën e Trajnimi të Policëve të Kosovës në Vushtrri si instruktor. Nga viti 1982 deri në vitin 1990, kam punuar në stacionin e policisë në Prizren si oficer police. Pastaj mua bashkë me shumë të tjerë na kanë larguar nga policia. Kam ardhur të jetoja në Vranoc me familjen. Ishte kohë e vështirë dhe nuk kisha shumë punë. Kështu, i hyra bujqësisë. Gjatë gjithë kësaj kohe, kam qenë nën përcjelljen e ish regjimit serb sepse ne nuk donim të punonim apo të bashkëpunonim me ta kundër popullatës sonë.
2. Unë do të hedhë dritë mbi historinë e konfliktit të armatosur në Kosovë, veçanërisht, në lidhje me gjërat që unë personalisht i kam përjetuar, apo që kam mundur t'i mësoj nëpërmjet kolegëve të mi. Do të vë në dukje qartësisht faktet që i kam mësuar prej të tjerëve. Gjithashtu, do të tregoj ato që kam përjetuar vetë personalisht gjatë postit që kam patur si komandant i UÇK-së, kur isha përgjegjës për stërvitjen e ushtarëve të UÇK-së në Luginën e Baranit (Lugu i Baranit). Në këtë luginë ka 17 fshatra.
3. Diku në vitin 1990, u pushova nga shërbimi si oficer policie. Në atë kohë, u liruan nga detyra gjithsej 74 oficerë police. Në 28 mars 1989, u miratua kushtetuta e re, me anë të së cilës Kosovës iu hoq autonomia. Pas kushtetutës së re, qeveria futi rregulla diskriminuese kundër shqiptarëve të Kosovës në forcën e policisë. Këto masa u futën kinse për të mbrojtur popullsinë prej separatistëve shqiptarë.
4. Në korrik 1990, kur u emërova në Stacionin e Policisë së Prizrenit si Inspektor policie, Z.**BOSHKOVIC**, komisar i policisë që përgjigjej për pesë komunat e Prizrenit, Dragashi, Rahoveci, Malisheva, dhe Suhareka, organizoi një mbledhje në Stacionin e Policisë së Prizrenit. Mbledhja u thirr për të diskutuar rregullat e reja të shërbimit. Ne nuk pajtoheshim me rregullat e reja, por asnjeri prej nesh nuk po ndërmernte ende hapin e parë për t'i kundërshtuar ato hapur. Unë mbrrita pak me vonesë në mbledhje, meqë po vija nga Peja.

Nënshkruar/inicialet:



2

të tjerë të pranishëm: nënshkrim



## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI

5. Kur arrita unë, kolegët u gëzuan. Ata prisnin që unë të flisja i pari. U bënë disa diskutime për një farë kohe para se unë të merrja fjalën për të thënë, "Në rast se policia vazhdon të keqtrajtojë njerëzit, sepse janë shqiptarë, atëhere ne si parti komuniste ekzistojmë vetëm në letër. Që nga ky moment, unë nuk e konsideroj veten më anëtar i Partisë Komuniste." Mora një fletë letre dhe u kërkova kolegëve, që mendonin si unë, të shënonin emrat e tyre në të. Letra m'u kthye me 44 emra. Pastaj hoqa fotografinë nga tesera e partisë që provonte anëtarësinë dhe lidhjen time me partinë. Brenda tri ditësh, 74 oficerë policie u nxorrën në lirim.
6. Që nga ajo kohë e tutje, policia serbe më mbante në vëzhgim të vazhdueshëm dhe, nëpërmjet kolegëve që vazhdonin të punonin ende në forcë, më ofroi që të kthehesha përsëri të punoja në rradhët e policisë. Ata gjithashtu u përpoqën edhe të më friksonin: më thanë se isha një separatist etnik. Unë u thashë se ne (oficerët e policisë) ishim përgatitur për të mbrojtur popullin dhe nuk na interesonte përkatësia etnike e tij. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Njerëzit duhen proceduar për krime të kryera dhe jo për shkak të përkatësisë së tyre etnike.
7. Në 1992, shkova në fshatin Hajle për të jetuar për rreth 3-4 muaj gjatë verës. Ky është vendi me lartësinë më të madhe në Bjeshkët e Rugovës . Një mbrëmje, teksa vazhdoja të isha në fshatin Hajle, na rrethoi ushtria dhe policia jugosllave. Midis oficerëve ishte edhe komandanti i policisë së Pejës, Bora VLAHOVIC. Atë mbrëmje, policia dhe ushtria mblodhën 18 familje nga i njëjti fshat, që të gjithë banorë të fshatit Vranoc, që kalonin pushimet e verës në Hajle, dhe i ndanë gratë dhe fëmijët prej burrave. Pjesa më e madhe e oficerëve të policisë, apo ushtrisë, ishin serbë. Këta oficerë po kryenin stërvitje në atë zonë. Ata i përdorën familjet dhe fshatin për t'u stërvitur në kushte reale, për të mësuar si të hynin në një fshat dhe si të rrethonin dhe trajtonin njerëzit e tij. I nxorrën të moshuarit përjashta në të ftohtë dhe i qëllonin në pëllëmbët e duarve me shkopinj gome. Burra më të rinj, si puna ime, ishin ndër viktimat. Ata na pyetën se ku ndodhej ushtria e Rugovës.

Nënshkruar/inicialet:



3

të tjerë të pranishëm: nënshkrim



## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI

Të rinjtë si puna ime, i detyruan të shtriheshin përtokë me duar dhe këmbë të shtrira dhe na hipën në duar me këpucë. Ata na keqtrajtuan shumë keq.

8. Ata keqtrajtuan edhe gratë dhe fëmijët. Një prej oficerëve të policisë goditi me shpullë edhe tim bir pesë vjeçar. Një tjetër më goditi me qytën e armës së tij snaipër në brinjë. Ata na i ngulën sytë ne 15 vetëve që ishim me moshë më të re dhe na thanë se ne e dinim ku ishte ushtria, por e mbanim të fshehtë. Ata dyshonin se ne mund të ishim anëtarë të ndonjë ushtrie. Por, ne u thamë se ishim civilë. Ata na keqtrajtuan për katër (4) orë dhe pastaj na lëshuan. Unë u ktheva në Pejë dhe u takova me Sami **SINANAJ**, i cili dërgoi një mjek ilaçe dhe mjete transporti për të ndihmuar njerëzit që ishin në bjeshkë. Ai ishte një civil me pushime në Kosovë. Ai jetonte në Hagë. Ky incident më bëri një përshtypje shumë të madhe. Incidente të tilla ishin të zakonshme. Çdo muaj, policia vinte në fshat dhe keqtrajton njerëzit. Justifikimi i zakonshëm i policisë ishte se kërkonte të gjente armë të paligjshme të i kishin njerëzit në pronësi.
9. Që nga ajo ditë në 1992, për mua ishte e qartë se ishte e pamundur të jetohej në paqe në Jugosllavi, e cila ndërkohë kish filluar të shpërbëhej. Së dyti, unë fillova t'i fshihesha vazhdimisht policisë serbe. Ata donin të më kapnin meqënëse isha anëtar i grupit të oficerëve të liruar të policisë që po luftonin për të marrë përsëri punën që kishin patur. Ne kishim bërë padi në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg. Gjithashtu, unë shkova në Bruksel, Hagë dhe në shumë qytete të Gjermanisë për të marrë pjesë në protesta kundër qeverisë jugosllave për heqjen tonë të padrejtë nga puna në shërbimin policor, që ishte një shkelje e të drejtave të njeriut. Gjatë asaj kohe bëra shumë udhëtime në Europë.
10. Policia mund të mendonte se isha terrorist. Meqënëse nuk ishin në gjendje të më kapnin, ata i bënin presion familjes sime. Ime shoqe bëri një padije fallco kundër meje dhe siguroi divorcin nga gjykata. E gjithë kjo u sajua prej nesh meqënëse doja të shpëtoja jetën e familjes sime nga ngacimet e policisë. Gjatë asaj kohe, kur i

Nënshkruar/inicialet:



4

të tjerë të pranishëm: nënshkrim



## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI

fshiheshja policisë, jetoja në malet e Hajles. Ndenje i fshehur kështu për të paktën 6 vjet.

11. Kishte edhe një dilemë tjetër. Të gjithë njerëzit që kishin punuar më parë për shtetin jugosllav, qoftë si oficerë policie, qoftë si oficerë ushtrie, nuk konsideroheshin njerëz të besuar. Ky ishte një mendim i përgjithshëm. E vërteta është se të gjithë ata që, për një arsye apo tjetrën, kishin patur kontakte me policinë serbe shiheshin si të dyshimtë nga UÇK-ja. Që të jem më i saktë, shqiptarët që vazhdonin të punonin në administratën shtetërore në polici, apo në departamente të tjera, mendohej se ishin bashkëpunorë të serbëve. Serbët i konsideronin si besnikë, kurse popullsia shqiptare i shihte si bashkëpunorë.
12. Por, jeta e punonjësve të mëparshëm të shtetit, si puna e oficerëve të policisë (si unë) ishte madje edhe më e vështirë, meqëse ne shiheshin si rebelë nga shteti dhe si bashkëpunorë të serbëve nga popullsia lokale dhe nga UÇK-ja. Gjendja u përkeqësua edhe më tej kur kriza e Bosnjës po i afrohej fundit dhe ne e dinim se shteti po përgatitej për një luftë të re civile në Kosovë.
13. Para se të dilte UÇK-ja në skenë, njerëzit ishin ende të paarmatosur; mjetet paqësore ishin më të përshtatshme për zgjidhjen e krizës. Dhe në përgjithësi, njerëzit i besonin politikave paqësore të Rugovës.
14. Erdhi një kohë kur njerëzit nisën të mendonin se mjetet paqësore nuk ishin të mjaftueshme. Rreth 1997, kishte shpërndarje të rregullta me forcë dhe arrestime të studentëve dhe profesorëve në Prishtinë, të cilët merrnin pjesë në demonstrimet paqësore në Prishtinë. Policia serbe arrestoi një numër të madh njerëzish. Edhe vajzat studente rriheshin, arresoteshin dhe ndaloheshin.
15. Këto revolta të popullsisë shqiptare në 1997 dhe shtypja e tyre nga ana e qeverisë serbe bënë që studentët e Prishtinës të largoheshin nga shkolla. Ata filluan të organizoheshin në grupe të ndryshme të UÇK-së në mbarë Kosovën. Ata formuan

Nënshkruar/inicialet:



5

të tjerë të pranishëm: nënshkrim




## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI

grupe, por nuk ishin ne gjendje të luftonin, meqënëse nuk kishin armë. Qëllimi i qeverisë serbe ishte që t'i shtynin njerëzit të shkonin në frontin e luftës dhe pastaj, nëpërmjet agjentëve të tyre, t'u shisnin atyre armë. Në këtë mënyrë ata do të kishin një justifikim për t'i luftuar ata hapur. Nuk dua të them se konflikte ndodhi vetëm për shkak se donte qeveria serbe. Popullsia shqiptare po ashtu donte liri, meqëse nuk ndihej e sigurtë nën serbët. Në këtë kohë, të gjithë donin të kishin një armë për të mbrojtur veten nga policia, meqë policia bastiste shtëpitë e tyre në mes të natës dhe arrestonte njerëz, duke i akuzuar si terroristë, bashkëpunorë të terroristëve dhe separatistë.

16. Ata që burgoseshin nën akuzën e të qenurit terroristë duhet të përdornin avokatë serbë për t'i mbrojtur, duke paguar një çmim të lartë. Dhe zakonisht, fshatrat që kishin vetëm popullsi shqiptare, i nënshtroheshin masave më shtypëse në krahasim me fshatrat me popullsi të përzier. Shqiptarët katolikë përgjithësisht lireshin rehat. Serbët u thoshin shqiptarëve katolikë që të bënin një kryq në muret e shtëpive të tyre, me qëllim që të dallohej nga larg, por shumica e katolikëve nuk e bëri këtë gjë. Megjithatë, disa e bënë kryqin në muret e shtëpive të tyre për shkak të frikës.

17. Serbët bastisnin fshatrat dhe shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës vazhdimisht me pretekstin e gjetjes së armëve. Ata u kërkonin njerëzve të dorëzonin armët. Madje edhe kur njerëzit i dorëzonin armët, policia përsëri i arrestonte, i merrte në pyetje dhe i rrihte, duke i pyetur për burimin e armëve, sikurse edhe për emrat e personave që kishin armë. Njerëzit përpiqeshin të afroreshin me policinë nëpërmjet fqinjëve të tyre serbë apo nëpërmjet shqiptarëve që vazhdonin ende të punonin për serbët, për të gjetur prehje nga ngacmimet e tyre. Këta ndërmjetësues u kërkonin shumë para shqiptarëve për t'u siguruar mbrojtje nga ngacmimet e policisë. Sasia e parave ndryshonte nga 500 deri në 1000 marka gjermane.

Nënshkruar/inicialet:



6


të tjerë të pranishëm: nënshkrim



## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI


18. Për shkak të këtyre ngacmimeve të vazhdueshme, njerëzit (sidomos të rinjtë, dhe ata që kërkoheshin nga policia) të cilët i kishin mundësitë, nisën të largoheshin nga Kosova për të kërkuar strehim në vende të tjera të Europës.
19. Në 1996, disa ish oficerë policie u dënuan dhe burgosën nga 8 deri në 16 vjet me burg nën akuzën e mbështetjes së separatistëve shqiptarë. Midis oficerëve të policisë që u dënuan ishin: Sheremet **AHMETI**, komisar i policisë për Kosovën, Destan **THAÇI**, Shaban **SHALA** (Peja), Halil **BLAKA**, komandanti i Stacionit të policisë së Prizrenit, Adem **SHALA**, zv/komisari i Policisë së Prizrenit. Numri i përgjithshëm i oficerëve të policisë së dënuar me burg ishte më shumë se 300. Akuzat ishin pak a shumë të njëjta. Unë punova me ta dhe i njihja personalisht Shaban **SHALËN**, Halil **BLAKËN** dhe Adem **SHALËN**.
20. Kështu, pra, për ta përmbledhur sfondin historik të konflikt të armatosur, do të thosha se, në përgjithësi, shqiptarët ishin shënjestra e masave të ashpra. Ata që donin të qëndronin në punët e tyre shiheshin si bashkëpunorë prej shqiptarëve të Kosovës; ata që u larguan prej punëve, shiheshin si të dyshimtë si prej regjimit serb, ashtu edhe prej nacionalistëve shqiptarë. Në këtë sfond arrestimesh, ndalimesh dhe dënimesh, disa njerëz vendosën të largohen nga Kosova, kurse disa të tjerë vendosën të ndërmarrin një luftë të armatosur për liri apo pavarësi.
21. Për herë të parë dëgjova për UÇK-në diku në 1993. Në atë kohë, fshihesha në male, dhe lexova për herë të parë për të në një gazetë të quajtur "BUJKU". Komunikatat e UÇK-në botoheshin në atë gazetë që nga ajo kohë e më pas, duke dhënë hollësi për veprimtaritë sulmuese të saj kundër stacioneve të policisë, patrullave të policisë, apo kundër bashkëpunorëve. Gjithësesi, shumica e popullsisë i priste komunikatat me pahir. Njerëzit ishin shumë entuziastë për to.
22. E dija që po zhvillohej një lëvizje rezistence në Kosovë kundër shtypjes nga ana e regjimit jugosllav pro-serb. Por, kjo lëvizje mbahej sekret në një farë mënyre deri në 1997.

Nënshkruar/inicialet:



7


të tjerë të pranishëm: nënshkrim




## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI


23. Në vjeshtë të 1997 (tetor apo nëntor), siç kam deklaruar në deklaratën time të mëparshme, kushëriri im Adrian **KRASNIQI** u vra në fshatin Kliqine nga policia. Ai ishte ushtar i UÇK-në dhe në kohën e vrasjes ishte i veshur me uniformën e UÇK-në. Ai ishte fshehur në malet e Drenicës dhe donte të shkonte në Shqipëri për të marrë armë për UÇK-në, nëpërmjet fshatit tonë Vranoc. Por, u vra në Kliqine. Adem **JASHARI** ishte komandanti i zonës së Drenicës, kurse kushëriri im ishte ushtar nën komandën e tij.
24. Më 1997, kushëriri im, Adrian **KRASNIQI**, student në Prishtinë është vrarë nga serbët në Kliçinë dhe pas kësaj vrasjeje serbët u angazhuan në një terror kundër gjithë popullatës në Pejë. Për shkak të represionit serb, filluam të organizoheshim në grupe të vogla për të përballuar represionin serb. Pasi që isha ish polic, fillova t'i ushtroja rekrutët në qitje, operacione dhe taktikë. Mu para sulmit të parë serb në fshatin Vranoc më 29 maj 1998, ne ishim vetëm një grup, por pas këtij sulmi fshati më zgjodhi mua si komandant. Në atë kohë nuk i përkisnim asnjë brigade, por në qershor të vitit 1998, e krijuam brigadën e Tretë. E emërtua si Brigada "Adrian **KRASNIQI**". Rrustem **BERISHA** u caktua komandant i kësaj brigade por ai nuk u paraqit asnjëherë pasi që jetonte në Shqipëri. Ai ishte ish kapiten i ushtrisë jugosllave dhe shpesh vinte në Kosovë nga Shqipëria. Kështu, Nazif **RAMABAJA** e mori këtë pozitë. Brigada Adrian **KRASNIQI** ishte e vendosur në Shkollën Filllore të Baranit, me Nazif **RAMABAJËN** si komandant. Në fillim të qershorit të vitit 1998, Nazifi dhe unë vendosëm ta krijonim policinë ushtarake në Baran të përbërë nga njerëz që ishin të trajnuar më mirë. Ish inspektori i policisë, Hasan Gashi, u bë komandant i tyre. Hasan **GASHI** ishte stacionuar me trupat e tij në shkollën e kuqe ku ishte sjellë Sanije **BALAJ**. Ai kishte nën komandën e tij rreth 30 ushtarë. Hasan **GASHI** ishte nga fshati Baran.
25. Pas incidentit, unë dola nga vendi ku rrija fshehur dhe mora pjesë në ceremoninë e varrimit të kushëririt tim. Aty më panë njerëzit. U takova me kolegët e kushëririt

Nënshkruar/inicialet:



8

të tjerë të pranishëm: nënshkrim






## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI

tim Adrian dhe diskutova me ta për vrasjen e tij. Ata të gjithë ishin më të rinj se unë. U thashë se nuk e dija se kush qëndronte pas maskës së UÇK-së.


26. Deri në atë kohë, ushtarët e UÇK-së mbanin maska, si në zonën e Drenicës, ashtu edhe në atë të Dukagjinit, dhe nuk kishin dalë hapur. Njerëzit në atë kohë kishin frikë nga njerëzit e maskuar, meqë nuk mund ta merrje vesh se kush ishin. Ushtarët e maskuar të UÇK-së vepronin në grupe të vegjël prej 5 apo 6 vetësh. Kushëriri im Adrian gjithashtu më kish thënë, kur ishte gjallë, që të futesha në rradhët e UÇK-së dhe të stërvisja ushtarët në Zonën Operative të Dukagjinit. Por, unë vazhdoja ende të mendohesha për t'u futur apo jo në UÇK. Unë isha oficer policie profesionist, i mirënjohur në zonë dhe nuk më pëlqente ideja e futjes në një ushtri njerëzish që mbanin maska. Ata duhet të shpalosnin identitetin e tyre që të mund të fitonin besimin e njerëzve. Në përgjithësi, e gjithë popullsia kishte të njëjtën frikë prej ushtarëve me maska sikundër edhe prej policisë dhe shërbimit të fshehtë serb.
27. Përpara masakrës së familjes **JASHARI** në janar 1998, rojet e fshatrave, të organizuara nga UÇK-ja, në përgjithësi, ishin të paarmatosur, por pas këtij incidenti, njerëzit filluan të armatoseshin.
28. Me sa më kujtohet, pas masakrës së Prekazit më 25 mars, 1998, unë u takova zyrtarisht me oficerin e ushtrisë jugosllave (JNA) të quajtur Rustem **TETAJ** në fshatin Lumbardhë, në janar 1998. Ky takim u zhvillua në shtëpinë e Hasan Musli **UKAJT**, dhe rreth dhjetë deri në dymbëdhjetë njerëz morën pjesë në të. Ne (Z.**TETAJ** dhe unë) e njihim që më parë njeri tjetrin. Diskutonim për aspektin organizativ të ushtrisë, edhe pse në atë kohë, unë nuk isha ende anëtar i UÇK-së. Mendonim se duhet të ishim shumë të kujdesshëm kur të ngrinim një ushtri sepse në të mund të futeshin edhe kriminelë/keqbërës. Në rast se ndodhte një gjë e tillë, do të binim në kurth, sepse kriminelët do t'i rrëmbenin armët për krime. Si rrjedhojë, në UÇK kishte nevojë për profesionistë për të mos lejuar që ushtria e UÇK-së të kthehej në një vendstrehim për keqbërësit. Unë isha i mendimit se

Nënshkruar/inicialet:



9

të tjerë të pranishëm: nënshkrim




## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI

njerëzit që donin të kishin një AK 47, duhet të dinin si dhe përse ta përdornin atë. Shumica e të rinjve, që kishin armë, nuk kishin ndonjë përgatitje zyrtare për përdorimin e saj. Në atë kohë ndodhi një incident; një djalë i ri vrau të motrën në kohën që po i tregonte familjes armën që kish marrë si anëtar i UÇK-së. Nuk e mbaj mend emrin e personit apo fshatin nga ishte. Dëgjova gjithashtu se në fshatin Pozar një grup djemsh po tregonin se sa mirë dinin të qëllonin dhe njeri prej djemve vrau një nga shokët e vet.

29. Pas takimit në fshatin Lumbardhë, ndodhi një vrasje në fshatin Buqan në fund të shkurtit, fillim të marsit 1998. Vëllai i Ismajl **SHALËS** u vra në një pritë nga policia serbe në fshatin Buqan. Ismajl **SHALA** ishte udhëheqësi i LDK-së për luginën e Baranit. Edhe ai gjithashtu u plagos. Në atë kohë, unë nuk kisha hyrë ende në UÇK.
30. Në shkurt 1998, Din **KRASNIQI** dërgoi kushëririn e tij Mete **KRASNIQIN** në shtëpinë time në Vranoc. U takova me Meten. Ai më tha se Din **KRASNIQI** donte që unë të futesha në rradhët e ushtrisë së UÇK-së. Ai më tha se ata (Mete dhe Dini) më besonin, meqë më njihnin mua dhe familjen time. Ai më tha se e dinin që nuk isha bashkëpunëtor serb. Ai më ftoi të shkoja dhe të stërvisja ushtarët e rinj të UÇK-së. Përgjigja ime ishte po.
31. Që nga ajo ditë, fillova të stërvis ushtarët e UÇK-së. Në fillim, i stërvisja në Vranoc e Vogël, në afërsi të lumit Lumbardh. Në atë kohë, Dr. Din **KRASNIQI** ishte komandanti i UÇK-së për Vranocin, dhe më pas edhe për Luginën e Baranit. Në luginë kishte 17 fshatra. I kam treguar ata në një hartë bashkëngjitur deklaratës sime si Aneksi "A". Në atë kohë, ushtarët ishin kryesisht në Buqan, Vranoc, dhe Vranoc e Vogël. Ishte diçka shumë e zakonshme në atë kohë që ushtarët e UÇK-së të shkonin në fshatra të tjerë për të hyrë në këtë forcë, sepse në këtë mënyrë familjet e tyre ishin të sigurtë ndaj ndonjë ngacmimi të mundshëm nga forcat serbe. Të rinjtë nga Lugina shkonin në Drenicë, kurse ata të Drenicës dhe të zonave të tjera vinin në Luginë për të hyrë në UÇK.

Nënshkruar/inicialet:



10

të tjerë të pranishëm: nënshkrim




## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI


32. Me qëllim që një rekrut i ri të futej në UÇK, duhej të shoqërohej nga një person që dilte garant për të, për të thënë se ishte i besueshëm. Ne merrnim të dhënat personale të këtij personi dhe e pyesnim se përse donte të hynte në UÇK-së. Rekruti i ri fillonte menjëherë stërvitjen dhe, më pas, gjatë një ceremonie, ku ngrihej flamuri, ai bënte betimin.
33. Zyra e Din **KRASNIQIT** gjendej në shtëpinë e tij në fshatin Vranoc. Ai kishte gjithashtu edhe një klinikë private në atë vend. Në shkurt 1998, nuk kishte shumë veta që kishin uniformë. Pjesa më e madhe e tyre, stërviteshin me tesha civile. Në shkurt 1998, ishte një fakt i njohur se në Jabllanicë ekzistonte një ushtri nën komandën e Lahi **BRAHIMAJT**. Din **KRASNIQI** e kishte vizituar Jabllanicën dhe meqë ishte një person i besuar, ishte lejuar ta quante veten si komandantin e Luginës së Baranit. Në shkurt, nuk ishte krijuar ende Zona e Dukagjinit. Në atë kohë, nuk kishte një komandant për të gjithë zonën, e cila më pas u quajt Zona e Dukagjinit.
34. Ditën e parë, unë kisha për të stërvitur 21 ushtarë. Unë i stërvisja si të përdornin dhe mbanin armë si për shembull, pushkët M48 dhe AK47. Shumë pak ushtarë të UÇK-së kishin pistoletë, meqë nuk ishte një armë për luftë. Më kujtohet kur stërvita një grup nga një deri në tre muaj për t'i përgatitur plotësisht për luftime. Rekruti më i mirë lejohej të udhëhiqte një grup prej 10 ushtarësh për të ngritur moralin e të mirëtrajnuarve.
35. Në atë kohë, UÇK-ja ishte e organizuar në Jabllanicë dhe Gillogjan. Të rinjtë armatoseshin nga këto dy shtabe; në fillim nuk bëhej fare stërvitje. Komandanti i UÇK-së në Jabllanicë ishte Lahi **BRAHIMAJ**. Lahi **BRAHIMAJ** është dajua i Ramush **HARADINAJT**. Jabllanica është shtabi më i vjetër i UÇK-së në Kosovën perëndimore, sepse ishte vend malor, ku forcat serbe nuk shkonin dot me lehtësi. Ata nuk donin të bënin një përlëshje të madhe për një fshat të vogël. Jabllanica njihej si një territoro i lirë që nga 1991. Në 1991, policia arrestoi një të

Nënshkruar/inicialet:



11

të tjerë të pranishëm: nënshkrim





## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI

kërkuar në atë fshat, të cilin pastaj fshatarët ua rrëmbyen nga duart policisë. Kjo gjë ishte poshtëruese për policinë dhe kështu ajo vendosi të mos ngatërrohej më me njerëzit e Jabllanicës.


36. Unë e vizitova shtabin në Jabllanicë në mars 1998. Shoqërohesha nga Dr. Din **KRASNIQI**, i cili donte të vizitonte disa djem të rinj që ishin plagosur në fshatin Suka e Cërmljanit. Ata ushtarë të UÇK-së ishin duke bërë roje në rrugë. Ushtria serbe donte të zinte majën e kodrës për të kontrolluar fshatin. Kjo bëri që të zhvillohej një betejë midis UÇK-së dhe forcave serbe. E di se në këtë betejë morën pjesë të paktën 300 ushtarë serbë dhe policë, me minimumi 4 tanke dhe disa kamionë ushtarakë. Ata ishin të armatosur me artileri të rëndë. Në fillim të këtij sulmi, numri i ushtarëve të UÇK-së ishte 4-5, por shpejt numri i tyre arriti 200-300, kur mbrirri ndihma nga shtabi dhe nga fshatrat fqinje. Beteja vazhdoi për rreth 5-6 orë, por serbët nuk u tërhoqën por qëndruan aty. Rreth 12-13 ushtarë të UÇK-së u plagosën në këtë betejë.
37. Ramush **HARADINAJ** ishte ushtar i UÇK-së që nga 1997 dhe ishte më të vëllanë Luan **HARADINAJ**, kur Luani u vra duke kaluar kufirin e Shqipërisë në vjeshtën e 1997. Ata po sillnin armë nga Shqipëria. Si rrjedhojë e kësaj prite, Ramush **HARADINAJ** nuk u fut dot në Kosovë dhe u kthye prapë në Shqipëri. Erdhi në Kosovë pas disa ditësh. Ramush **HARADINAJ** e varrosi të vëllanë në Shqipëri dhe u kthye në Kosovë më pas.
38. Megjithatë, familja **HARADINAJ** doli në dritë të plotë pas sulmit të forcave serbe kundër shtëpisë së **HARADINAJVE** në fshatin Gllogjan. Në atë kohë, UÇK-ja ishte vetëm një forcë guerrile. Deri atëhere, ne kishim ushtarë të UÇK-së, por ata nuk ishin në gjendje t'i ndalonin forcat serbe që të patrullonin zonën e Dukagjinit, apo të Luginës së Baranit. Pak kohë pas incidentit, populli i Zonës së Dukagjinit filloi të armatosej. Në atë kohë unë nuk isha në Gllogjan. Nuk e kam vizituar fshatin pas këtij incidenti. Nuk di shumë për të.

Nënshkruar/inicialet:



12

të tjerë të pranishëm: nënshkrim




## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI

39. Në televizionin shtetëror u tha se gjoja një patrullë e policisë serbe u sulmua në Glllogjan. Gjatë këtij sulmi, u përdorën granada dore. U treguan edhe granada dore të pashpërthyer.
40. Ky incident i dha Ramush **HARADINAJT** një popullaritet shumë të madh në Kosovë. Ai nuk u plagos rëndë gjatë këtij sulmi. Nuk e di nëse ai shkoi në Jabllanicë për t'u mjekuar. Pas këtij incidenti, Deçani u bë komuna e dytë, që i rezistoi fuqimisht forcave serbe, pas Prekazit në komunën e Skënderajt, ku ishte zhvilluar një betejë e ashpër midis familjes Jashari dhe forcave serbe nga data 21 deri në 25 mars 1998. Pas këtij incidenti, fshati Glllogjan u bë shtabi më i rëndësishëm i UÇK-së pas Jabllanicës.
41. Komandant i përgjithshëm i Zonës Operative të Dukagjinit ishte Ramush HARADINAJ i cili e kishte shtabin në fshatin e tij, Glllogjan. Sali VESELI ishte Komandant i Operacioneve për Zonën Operative të Dukagjinit (ZOD), ndërsa Rrustem TETA ishte Zëvendës Komandant. Nazif RAMABAJA ishte komandant i Brigadës së Tretë në Baran, Tahir ZEMAJ ishte komandant i Brigadës së parë në Prapaçan dhe Musa GJAKOVA ishte komandant i Brigadës së Dytë në Bardhaniq. Që të tri brigadat ishin në parim nën Ramush HARADINAJN, i cili ishte komandant i përgjithshëm, por këto në një mënyrë ishin të pavarura sepse nuk kishte sisteme të rregullta të raportimit në bazë ditore, Por, në rast nevojë apo kur kishte probleme, duhej të kontaktohej Komandanti i Zonës. Përndryshe të gjithë komandantët e brigadave i kishin udhëzimet e veta përkatëse për detyrën.
42. Gjatë sulmit kundër Glllogjanit, forcat serbe e nënvlerësuan forcën e Ramush **HARADINAJT**. Ata e sulmuan atë me polici dhe me njësinë e operacioneve speciale. Ata u detyruan të tërhiqeshin. Sulmi kundër Glllogjanit ishte fitorja e parë publike e ushtrisë guerilase të UÇK-së. Në Prekaz, serbët mundën ta shtypin UÇK-së, kurse në Glllogjan, ata pësuan disfatë. Pas këtij incidenti, UÇK-ja doli

Nënshkruar/inicialet:



13

të tjerë të pranishëm: nënshkrim






hapur. Deri në atë kohë, forcat serbe mund të patrullonin zonat e Dukagjinit lirisht, por pas kësaj disfate, ata u bënë të kujdesshëm.

43. Kur ndodhi incidenti i sulmit të Gllogjanit, unë vazhdoja të stërvisja ushtarët e UÇK-së në Vranoc e Vogël. Meqë isha nën komandën e Dr. Din **KRASNIQIT**, shpesh shkoja ta takoja në mbrëmje, për të diskutuar me të çështje profesionale. Gjatë këtyre takimeve, mësova se pas sulmit kundër Gllogjanit, në Jabllanicë bëheshin mbledhje ku merrte pjesë edhe Dr. Dini. Në këto mbledhje, ata festonin fitoret dhe u vendos që ta organizonin UÇK-së mirë e më mirë. Gllogjani u diskutua si një shembull që duhej ndjekur. Ishte një moment kur populli filloi të besonte tek ushtria e tij dhe ta mbështeste hapur UÇK-së. Në Prishtinë u organizuar demonstrata të studentëve në mbështetje të UÇK-së. Pas kësaj, shumë studentë hynë në rradhët e UÇK-së. Gllogjani u pranua si pika qendrore e UÇK-së në të gjithë Pejën dhe Deçanin, dhe Ramush **HARADINAJ** si komandanti popullor i forcave të UÇK-së në zonën e Dukagjinit.

44. Kishte rreth 40-50 fshatra në zonën e Dukagjinit nën kontrollin e UÇK-së në mars 1998. Çdo fshat kishte komandantin e tij, të zgjedhur prej shtabit të fshatit. Struktura në nivel fshati përbëhej nga një komandant i përgjithshëm, një zv/komandant, komandanti i operacioneve (që përgjigjej për stërvitjen e ushtarëve), komandanti i logjistikës, dhe komandanti i rojeve. Komandanti i operacioneve kish për detyrë t'i vinte në ndihmë çdo fshat që sulmohej, në gjithë zonën. Komandanti i logjistikës përgjigjej për furnizimet. Komandanti i rojeve ishte përgjegjës për rojet e fshatit. Oficerët e logjistikës nën komandën e komandantit të logjistikës mblidhnin kontribute monetare nga fshatarët për të blerë furnizime dhe armë.

45. Në fillim, secili fshat paguante për armët. Njerëzit dërgoheshin në Shqipëri, Serbi dhe Mal të Zi, për të blerë armë nëpërmjet Jabllanicës dhe Prekazit. Pas marsit 1998, komandantë e fshatrat zgjidhnin disa djem të rinj të guximshëm që dërgoheshin në Shqipëri për të blerë armë. Armët siguroheshin nga Diaspora






## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI

shqiptare. Këta të rinj dërgoheshin në Glogjan tek Ramush **HARADINAJ**, i cili i niste në Shqipëri me kontakte. UÇK-ja i shoqëronte këta djem gjatë rrugës. Ata ktheheshin me armë në fshatrat e tyre.


46. Që në mars 1998, forcat serbe ishin të dislokuara në kazermën e Pejës. Ata ishin të vendosur në stacionin e policisë në Deçan. Ata dislokoeshin edhe në një kodër të quajtur Suka e Babaloqit. Pozicioni i kodrës i ndihmonte ata të kontrollonin nga sipër fshatrat e zonës përreth si Babaloq, Gramacelë, Rastavicë, Glllogjan, Irzniq, Ratishë, dhe Prilep, etj.
47. Forcat serbe kontrollonin gjithashtu edhe rrugën kryesore midis Pejës, Deçanit dhe Gjakovës. Por ata nuk guxonin të hynin brenda në fshatra. Ata kishin frikë se mos i sulmonte UÇK-ja. Gjithashtu ata kontrollonin edhe rrugën Pejë-Klinë. Kishte një njësi artilerie serbe të dislokuar në fshatin Kerstec (Pejë). Fshatrat Bezhenik, Goradze, Doberdol, Vragoc, Babic dhe Kerstec ( të gjithë në komunën e Pejës) ishin fshatra serbe ku popullsia ishte plotësisht e armatosur. Forcat serbe e fshehën artilerinë e tyre në fshatin Voljake në komunën e Klinës.
48. Pjesa tjetër e fshatrave në komunitat e Pejës, Deçanit dhe Klinës ishin nën kontrollin e UÇK-së. MUP ishte tërhequr në Stacionin e Policisë së Irzniqit nga ku u evakua në fillim të majit 1998. Stacioni i fundit i policisë së MUP-it në Zonën e Dukagjinit u evakua në fshatin Qllapek në qershor 1998. UÇK-ja mundi gjithashtu të bllokonte rrugën kryesore Deçan-Gjakovë në afërsi të fshatit Prilep, në prill-maj 1998. Në këtë vend, në atë kohë, zhvilloheshin beteja të rregullta me armë midis forcave serbe dhe forcave të UÇK-së.
49. Kam treguar me të kuqe pozicionet e forcave serbe dhe fshatrat serbe që përmenden më ishpër në një hartë të bashkëngjitur si Aneksi "B".
50. Nga fundi i marsit 1998 deri në.../mungon në origji/ forcat serbe granatonin fshatrat e Zonës së Dukagjinit nga pozicionet e artilerisë së tyre.

Nënshkruar/inicialet:



15


të tjerë të pranishëm: nënshkrim




## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI


51. Deri në 28 maj 1998, unë vazhdova të stërvis ushtarët në Vranoc e Vogël. Në 29 maj 1998, forcat serbe e rrethuan fshatin gjatë natës. Ata erdhën me 14 kamionë të rëndë ushtarakë. Ne u kapëm në befasi. Policia dhe ushtria hyri në llogoret tona në kodrën e Gllavicës dhe na i mori pozicionet pa shtënë as edhe një herë. Ata donin që t'i vinin zjarrin fshatit. Ne u tërhoqëm dhe i ndaluan forcat serbe në fshatin Vranoc e Madhe.
52. Beteja nisi në orën 0500 të mëngjesit dhe zgjati deri në orën 1800 në mbrëmje. Unë u plagosa në dorë, në këmbë, dhe shpinë nga granada dore të hedhura nga serbët. Dy ushtarë të tjerë u plagosën. Serbët nuk mundën të hynin në fshat për shkak të rezistencës sonë. Neve na erdhi ndihmë nga Irznici, Buqani, Jabllanica, Macniku, Dashinoci, Luka, Pozare, Lumbardhi, etj. Rreth kësaj kohe, UÇK-ja ishte e mirëorganizuar dhe e aq e fortë sa t'i bënte ballë forcave serbe. Për UÇK-në, kjo ishte një betejë e suksesshme. Kur filloi betje, ne kishim vetëm 13 armë. Kishim granada hedhës shumë të mirë. Kishim gjithashtu edhe dy mitraloza të lehtë, dy snajpera, Kalashnikovë dhe granada dore.
53. Mbjaj mend se hodha një granadë dore që nuk plasi. Kjo gjë i trembi edhe më shumë forcat serbe, kështu që ne filluam të gjuanim me granada dore të paplasura për t'i trembur ata. Dhe kjo gjë pati rezultat.
54. Serbët zunë pozicion në kodër. Ata u tërhoqën nga kodra në mbrëmje dhe u kthyen në Qllapek, Strelc dhe në qytetin e Deçanit. Pjesa tjetër shkoi në kazermë në Pejë. Por, ata nuk mundën të hynin në Luginën e Baranit. Komandantët e mi ishin shumë të gëzuar me që unë udhëhoqa betejën nga fillimi në fund. Njerëzit ishin të lumtur. 25000 njerëz shpëtuan. Pati vetëm katër viktime civile. Në këtë betejë, u vranë rreth 400-450 bagëti si pasojë e të shtënave me artileri të forcave serbe.

Nënshkruar/inicialet:



16

të tjerë të pranishëm: nënshkrim







## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI


55. Po atë ditë, serbët u përpoqën të futeshin në fshatin Krushac, në komunën e Pejës, por nuk arritën.
56. Serbët krijuan një vijë fronti apo një barrikadë midis tyre dhe pozicioneve të UÇK-së dhe pastaj pati sulme sporadike midis tyre. Serbët vetëm granatonin fshatrat me artileri. Në maj, popullsia lokale e Poberxhës, Llokanes, Vokshit, Silubit, Drenocit, Libushes, Strelcës, dhe Lubeniqit u larguan nga fshatrat e tyre për shkak të granatimeve serbe, dhe u strehuan në zonën e lirë që kontrollohej nga UÇK-ja, sidomos në Luginën e Baranit, dhe në fshatra të tilla si Isnic, Lluka, etj. Forcat serbe u vendosën në fshatin Hulaj dhe nuk guxuan të hynin në ndonjerin prej fshatrave të Luginës së Baranit. Vetëm sa i granatonin. I kam treguar fshatrat që u sulmuan në hartën e bashkëngjitur si Aneksi "D". Vijat e kuqe tregojnë pozicionet e forcave serbe.
57. UÇK-ja kontrollonte fshatrat Poberxhe dhe Voksh, meqënëse këta ishin të vendosur përgjatë rrugëve të furnizimit me armë. Serbët hynë një herë në prill apo në fillim të majit 1998 në fshatrat Poberxhe dhe Voksh, dhe u vunë zjarrin. Por u larguan përsëri, sepse nuk i mbanin dot këta fshatra.
58. Në fillim të prillit 1998, Rustem **TETAJ** shkoi në fshatin Gllogjan për t'u takuar me Ramush **HARADINAJ**, Rustem **TETAJT** iu dha një pozitë në Shtabin e Përgjithshëm (Gllogjan), por nuk e di se çfarë posti.
59. Me sa mbaj mendm, së pari dëgjova për Shqiponjat e Zeza në qershor 1998. Dëgjova se e kishin qendrën në Irznic dhe se po stërviteshin shumë. Por nuk shkova kurrë të vizitoja shtabin e tyre. Shkova në Irznic në gusht 1998 kur po sulmohej Gllogjani. Në atë kohë, e pashë shtabin e Shqiponjave të Zeza për herë të parë.
60. Dëgjova për Togerin për herë të parë në maj 1998 dhe rreth asaj kohe e pashë në shtabin e fshatin Lumbardh. Ishte një takim i shkurtër. Ai ishte me një xhip të zi

Nënshkruar/inicialet:



17

të tjerë të pranishëm: nënshkrim




## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI

dhe kish veshur uniformë të zezë. Hapi dritaren e xhipit, më përshëndeti dhe vazhdoi rrugën për në Pozare. Dëgjova prej të tjerëve se ai ishte Togeri. Kisht një pamje mjaft të sëmurë. Ai është i njëjti person që është treguar si Togeri nga Tribunali, që njihet me emrin Idriz **BALAJ**.


61. Mbaj mend ta kem takuar Rmush **HARADINAJN** për herë të parë në prill në fshatin Vranoc e Vogël, në një fushë, pranë lumit Lumbardhë. Unë isha aty duke stërvitur ushtarët. Ai donte të na takonte. Në atë kohë, ne ishim duke bërë një pushim. Ramushi na përshëndeti dhe tha se po bënim një punë shumë të mirë dhe se duhe të vazhdonim ashtu. Mendoj se Rustem **TETAJ** ishte me Ramush **HARADINAJN**. Në atë kohë, Ramush **HARADINAJ** nuk ishte bërë zyrtarisht komandanti i Zonës së Dukagjinit, por ne e shihnim me respekt si udhëheqës dhe si komandant de facto.
62. Dëgjova nga Dr. Din **KRASNIQI** në maj 1998, se kishte një mbledhje në Glllogjan ku mori pjesë edhe Dr. Dini. Në atë mbledhje, komandantët e fshatrave dhe përfaqësuesit e fshatrave e zgjodhën Ramush **HARADINAJN** si komandantin e Zonës së Dukagjinit. Në atë kohë, Lahi **BRAHIMAJ** ishte komandanti i Jabllanicës, por mendoj se ishte zëvendësi i Ramush **HARADINAJT**.
63. Në qershor 1998, ne kaluam nga Vranoc e Vogël në ndërtesën e shkollës së re të Baranit dhe aty filluam të stërvisnim ushtarët. Aty kisha dhe zyrën, dhe ushtarët.
64. Në qershor 1998, oficerët e FARK-ut, nën komandën e Tahir **ZEMËS** mbrritën në Zonën e Dukagjinit (ZOD) nga Shqipëria. Oficerët e FARK-ut që takova unë ishin Nazif **RAMABAJA**, Musa **DRAGA**, dhe Esat **ADEMAJ**. Ata ishin caktuar të bënin pjesë në brigadën time. Kjo brigade u krijua pothuaj në të njëjtën kohë që erdhi FARK-u. Në fillim, u quajt Brigada Adrian **KRASNIQI**, pastaj u quajt Brigada Isuf **GËRVALLA**. Ishte brigada 131 ( e njohur edhe si brigada e tretë e zonës së Dukagjinit). Rustem **BERISHA** u caktua komandant brigade, por ai

Nënshkruar/inicialet:



18

të tjerë të pranishëm: nënshkrim




## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI


kurrë nuk e mori nën kontroll brigadën. Në vendin e tij si komandant punonte Nazif **RAMABAJA**.

65. Siç thashë edhe në deklaratën time të mëparshme, komandanti i përgjithshëm i Zonës Operative të Dukagjinit ishte Ramush **HARADINAJ** i cili e kishte shtabin e tij në fshatin e tij në Glllogjan. Sali **VESELI** ishte komandanti i operacioneve për ZOD, kurse Rrustem **TETAJ** ishte zv/komandant. Nazif **RAMABAJA** ishte komandanti i brigadës së tretë (që thirrej edhe si brigada 131), në Baran, Tahir **ZEMAJ** ishte komandanti i brigadës së parë, në Prapacan dhe Musa **GJAKOVA** ishte komandanti i brigadës së dytë, në Bardhanic. Të trija brigadat ishin në parim nën komandën e Ramush **HARADINAJT**, i cili ishte komandanti i përgjithshëm, por ato ishin në një farë mënyre edhe të pavarura, sepse nuk ekzistonte sistemi i rregullt i raportimit ditor. Por, në rast nevoja apo problemi, duhej kontaktuar komandnati i zonës. Përndrysh, të gjithë komandantët e brigadave kishin udhëzime për ta bërë si duhet punën e tyre.

66. Ramush **HARADINAJ** vizitoi brigadën tonë dy apo tri herë kur isha unë aty. Ramush **HARADINAJ** ishte zakonisht një person shumë dinamik. Nuk fliste shumë, por lëvizte shumë në zonën e tij, për të patur kontakte të drejtpërdrejta personale me forcat dhe me komandantët e fshatrave. Edhe unë fola me të për organizimin e UÇK-së. U takova me të dhe diskutova gjatë ceremonisë së betimit në Barane në 20 korrik 1998.


67. Ceremonia drejtohej nga Nazif **RAMABAJA**. Kishte rreth tre qind (300) ushtarë. Ngjarja u rregjistrua edhe në video. Kishte një numër të madh civilësh nga familjet e ushtarëve dhe nga fshati Barane. Në këtë rast, Ramush **HARADINAJ**, Rrustem **TETAJ**, Nazif **RAMABAJA** dhe Tahir **ZEMAJ** mbajtën fjalime. Të gjithë ushtarët e pranishëm bënë betimin. Kishte një listë ku ushtarët shkruanin emrin dhe mbiemrin, dhe merrnin një letër në të cilën ishte shtypur betimi. Ata shënuan edhe datën e bërjes së betimit, dhe iu tha që këtë copë letër ta mbanin si certifikatë.

Nënshkruar/inicialet:



19

të tjerë të pranishëm: nënshkrim




## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI


68. Unë i raportoja Nazif Ramabajës, i cili i raportonte Tahir Zemajt dhe Ramush Haradinajt. Nazifi më pyeste ta dërgoja njësitin në vijën e frontit dhe unë ashtu bëja. Pyeste edhe a ishte dikush i përgatitur të shkoj të ndihmojë në vijën e frontit.
69. Shqiponjat e Zeza ishin te njohura dhe kishin besimin e njerëzve. Njësitit kishte detyra të vështira në krahasim me njësitet tjera. Vetëm pas luftës dëgjova se disa anëtarë akuzohen të kenë kryer krime lufte, si p.sh. keqpërdorimi i uniformës. Nëse ndonjë fshat sulmohej ata ishin të parët që ofronin ndihmë. Nuk kam dijeni për kufoma të gjetura përgjatë kanalit të liqenit të Radoniqit.
70. UÇK-ja nuk kishte burgje zyrtare ose qendra praburgimi në zonën time. Nesë ndokush ishte i dyshuar, mbahej në të njejtën shtëpi ku qëndronin edhe ushtarët e UÇK-së, por mbaheshin të izoluar. Këtu përfshiheshin edhe ata që kishin shkelur dicsiplinën e UÇK-së.
71. Kemi përdorur radion lidhje për komunikim kur kemi pas mundësi, por ishin të dobëta dhe serbët bllokonin frekuencën që ne përdornim. Kishim një ose dy telefona satelitor, por i kemi përdorur shumë rrallë sepse ishin të shtrenjtë. Nuk kishim mundësi të përdornim teledona mobil sepse antenat ishin në zonat e kontrolluara nga serbët. Shpesh kemi përdorur korrier për të percjellur porositë mes njësiteve dhe fshatrave.
72. Njësitit i policisë ushtarake është formuar në Baran nga fundi i majit osë fillimi i qershorit të vitit 1998. Ishte e vendosur në Baran, kishte rreth 30 anëtarë dhe ishte nën komandën e Hasan Gashit. Zona e përgjegjësisë përfshinte rreth 17 fshatarë. Dy anëtarë nga secili fshat ishin caktuar në fshat për të mos u keqëtrajtuar fshatarët. Antarët veshnin çfarëdo që kishin. Disa kishin veshur pantollona dhe këmisha të zeza, port ë gjithë kishin emblema të UÇK-së. Ky njësit shkonte i pari në fshatrat të cilat sulmoheshin dhe siguronte largimin e popullatës. Gjithashtu siguronte që aktet e ndaluara të mos kryheshin. Nëse dikush kryente akte të

Nënshkruar/inicialet:



20

të tjerë të pranishëm: nënshkrim





## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI

ndaluara, ata e merrnin të dyshuarin në pyetje. Të dyshuarit liroheshin sepse nuk kishtë qendra paraburgimi. Fadil Nimonaj është caktu komandant nga gushti i vitit 1998.

73. Policia ushtarake duhej të vendoste diciplinën në UÇK. Unë personalisht vendosja diciplinën duke biseduar me ushtarët në njësitin tim dhe njësiteve tjera. Një shembull ishte ankesa e një civili se një ushtarë i UÇK-së i kishte marrë makinën pa lejen e komandantëve të UÇK-së. Shkova të prindërit e ushtarit dhe iu thashë ta kthej makinën ose do të ndërmerrem “masat e nevojshme”. Ushtari ktheu makinën. “Masat e nevojshme” ishin përjashtimi nga UÇK-ja dhe çarmatimi.
74. Mendoj se kishte disa familje serbe në Ratishë, Dashinoc, dhe Lumbardhë. Këto familje u evakuan nga forcat sserbe në prill dhe maj 1998. Disa serbë që nuk u larguan në atë kohë, u larguan vetë më vonë. Disa prej këtyre serbëve, u ndihmuan prej shqiptarëve. Mbaj mend gjithashtu që kam shoqëruar një serb të tillë, një burrë të vjetër, por tani nuk më kujtohet emri i tij. Ai ishte ose nga Mezniku, ose nga Dashinoci. Halil **DERVISHAJ** nga Mezniku erdhi të më takonte që ky serbi të mund të largohet. Ai duhet t’ia dijë emrin e serbit të larguar.
75. Dëgjova se ishin shkëmbyer disa fjalë midis ushtarëve të Tahir **ZEMAJT** dhe ushtarëve të UÇK-së në Prapacan. Por, Tahir **ZEMAJ** e zgjidhi mirë mosmarrëveshjen. Nuk mbaj mend datën apo muajin kur ndodhi ky incident.
76. E di se vetë Ramush **HARADINAJ** i solli njerëzit e FARK-ut tek unë në Baran në qershor 1998. Nuk e di nëse ka patur ndonjë mosmarrëveshje midis tyre. Nuk jam në dijeni të ndonjë incidenti tjetër që mund të ketë ndodhur midis FARK-ut dhe UÇK-së.
77. Një betejë shumë e rëndësishme u zhvillua midis forcave serbe dhe forcave të UÇK-së në datën 6 qershor 1998. Kjo njihet si beteja e Loxhës. Artileria serbe ishte vendosur në kodrën Taba të Pejës. Kodra është pjesë e qytetit të Pejës.

Nënshkruar/inicialet:



21

të tjerë të pranishëm: nënshkrim



## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI

Ndodhet sipër Stacionit të Policisë. Në 5 qershor 1998, forcat serbe hodhën një granadë dore në një shtëpi shqiptare në fshatin Loxha. Një person u vra dhe dy u plagosën. Në 6 qershor 1998, forcat serbe filluan të granatonin Loxhën. U informuam se Loxha po sulmohej. Të gjithë ushtarët e UÇK-së në fshatrat e zonës së lirë (Zona e Dukagjinit) shkuan në mbrojtje të Loxhës.


78. U zhvillua një betejë e ashpër. Betej udhëhiqej nga Nazif **RAMABAJA**. Oficerë si Rustem **BRUCI**, Skënder **CEKU**, Esat **ADEMAJ**, Shaban **SHALA**, Tahir **ZEMAJ** dhe Ramush **HARADINAJ** morën pjesë në atë betejë. Rreth 300 ushtarë ose edhe më shumë luftuan në anën e shqiptarëve. Atë ditë, plumbat tanë shkuan deri në qytetin e Pejës. Por ne nuk kishim municion të mjaftueshëm për ta marrë qytetin e Pejës. Popullsia serbe po largohej në panik. Ne nuk hymë në Pejë dhe mbajtëm Loxhën.

79. Një muaj më vonë, në korrik, forcat serbe hynë në Loxhë dhe e shkatërruan atë krejtësisht. Unë kam shënuar në hartë pozicionet e Serbëve me të kuqe kurse pozicionet e shqiptarëve me të kaltër në betejën e parë të Loxhës. Ajo është bashkangjitur si Aneksi "E".

80. Për mendimin tim, një bashkëpunor gjatë konfliktit ishte një person i cili punonte për të mirën e armikut të popullit. Për shembull, ishte një person i quajtur Sali **SHKRELI** nga fshati Kosuric. Ai ishte bashkëpunor me serbët me gjithë familjen e tij. Ai njihej si i UDB-së (Shërbimi i fshehtë jugosllav). Ai u jepte informata serbëve për ushtarët e UÇK-së para dhe gjatë konfliktit. Ai u arrestua në fund të qershorit 1998 prej nesh. U mor në pyetje në Barane nga Toger (Idriz **BALAJ**) dhe Mete **KRASNIQI**.



81. Dëgjova se i ndaluar i gjoja paska thënë se donte bë bëhej anëtar i UÇK-së me gjithë familjen e tij. Kur mori leje nga Ramush **HARADINAJ** të lëvizte lirisht në zonë, Saliu hyri me forcë në shtëpinë e një shqiptari dhe e mori atë në zotërim. Familjen e nxorri jashtë shtëpisë dhe erdhi tek ne. Gjatë ofensivës serbe të gushtit,

Nënshkruar/inicialet:



22

të tjerë të pranishëm: nënshkrim

## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI

Sali **SHKRELI** dhe djali i tij u treguan serbëve rrugën për të hyrë në fshatin Gllogjan dhe në fshatra të tjera. Në këtë ofensivë, të gjitha fshatrat u dogjën fare dhe popullsia u përqëndrua në Isnic dhe Prapacan. Njerëzit ndenjën në këto fshatrat për shtatë ditë para se të largoheshin me Tahir **ZEMAJN** për në Shqipëri.


82. Të gjitha fshatrat u plaçkitën dhe u dogjën pas kësaj ofensive. Kjo ofensivë nisi rreth datës 26/27 gusht dhe zgjati deri në datën 5 apo 6 shtator 1998.
83. Unë luftova në afërsi të Jabllanicës. U tërhoqa në fshatin Buqan dhe që andej shkova në Vranoc. Forcat serbe ndenjën në Buqan një natë. Të nesërmen, ato filluan përsëri ofensivën në Vranoc. Ndërkohë ishte shtator 1998. Civilët e kishin braktisur fshatin, forcat serbe filluan të plaçkisnin dhe të festonin.
84. Pas lufte, Saliu iku në Serbi me familjen dhe nuk i ndodhi asgjë.
85. Dënimi i të qenit bashkëpuntor ishte natyrisht burgim me jetë. UÇK-ja nuk kishte ndonjë sistem për t'i bërë një gjykim të drejtë një bashkëpuntori. UÇK-ja nuk zuri asnjërin prej tyre. [REDACTED]
86. Kur fola për dënimin me burg të përjetshëm të bashkëpunësorëve desha të them se ne mendonim se si do të mirreshim më këta njerëz pas luftë. Në atë kohë nuk kishin gjyqe ushtarake.
87. Ishte detyra e secilit prej ushtarëve të UÇK-së që të raportonte një bashkëpuntor, në rast se e njihje. Por, unë nuk di që të ketë patur njeri për detyrë të posaçme që të merrej me bashkëpunorët. Ne nuk kishim kohë të mendonim për këtë gjë për shkak të angazhimeve që kishim në luftë.
88. Diku para shtatorit 1998, dëgjova për rrëmbimin e një çifti të quajtur Nurije dhe Istref **KRASNIQI**. Tahir **ZEMAJ** më ftoi në Prapacan për të më pyetur nëse e

Nënshkruar/inicialet:




23

të tjerë të pranishëm: nënshkrim





## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI

- dija se çkish ndodhur me çiftin. Ai më tha se Fadil **NIMONI** ishte komandant i Policisë Ushtarake, dhe ishte caktuar të merrej me rastin e çiftit **KRASNIQI**. I thashë Tahirit të sqaronte këtë punë me Policinë Ushtarake meqë ata patrullonin nëpër fshatra.
89. Më vonë dëgjova thashetheme të ndryshme për vrasjen e tyre. Fjalët thoshin se ata paskëshin bashkëpunuar me serbët. Unë u habita paksa sepse nuk e dija se çfarë mund të kishin bërë ata (vrasësit) për të verifikuar këto akuza. Nuk e di kush mund t'i ketë vrarë.
90. Gjatë gjithë kohës nga prilli 1998, deri në fund të gushtit 1998, Zona e Dukagjinit ka qenë përgjithësisht një zonë e lirë tërësisht, nën kontrollin e UÇK-së me përjashtim të kufijve të zonës. Kam theksuar me bojë të kaltër në hartë zonën që kontrollohej nga UÇK-ja gjatë gjithë kohës nga prilli 1998, deri në gusht 1998. Pozicionet serbe janë theksuar me bojë të kuqe. Harta i është bashkëngjitur deklaratës sime si Aneksi "C". Gjatë kësaj kohe, forcat serbe nuk mund të hynin në këtë zonë të lirë. Kjo njihet si zonë e lirë edhe për shkak të faktit që u çlirua nga pushtimi serb. Këto fshatra granatoheshin me artileri gjatë kësaj periudhe, meqë nuk kishin mbetur më pothuaj civile serbë në këto fshatra me përjashtim të disa të moshuarve.
91. Nuk e di se çfarë pozite ka patur Faton **MEHMETAJ**. Ai ishte nga Pozara. E di që ka qenë në Jabllanicë. Por e di se është takuar shumë herë me Mete **KRASNIQIN**. Nuk e di se për çfarë kanë biseduar.
92. E njoh Sadri **SELCËN**. Ai ka qenë anëtar i UÇK-së me qendër në Barane dhe nën Nazif **RAMABAJËN**. Ai përgjigjej për çështje disiplinore.
93. Në gusht 1998 (rreth datës 2 gusht) Nazif **RAMABAJA** më tha se po sulmohej Gllogjani. Ai më tha të shkoja aty për ta ndihmuar. Unë u largova me një kamion me 25 ushtarë dhe dy shoferë. Mbrrita aty rreth mesditës. Ushtarët zbritën përpara

Nënshkruar/inicialet: 

24

të tjerë të pranishëm: nënshkrim 





## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI

shtabit. U takova me Ramushin dhe e pyeta për gjendjen. Ai më tha se ishte serioze. Shtëpia e Ramush **HARADINAJT** ishte shkatërruar pjesërisht. Ai më tha të shkoja në Gramacel dhe Dubravë. Po na sulmonin. Forcat serbe po na qëllonin nga një largësi. Ata ishin të vendosur në Sukën e Babaloqit dhe Sukën e Gramacelës dhe lart në Prilep. Zura urën e Gramacelës për të penguar forcat që të hynin në Dubravë. Qëndrova më Gramacelë dy ditë e dy netë. Nuk kishte popullsi civile. Forcat serbe hynë në fshatin Gramacel dhe e shtinë në dorë. Ishte fundi i gushtit.


94. U ktheva aty përsëri ditën e tretë. Forcat serbe hynë në shkollën e fshatit Gllogjan nga Shepteji. Unë munda të shkoj në shtabin e Gllogjanit. Aty qëndrova 5 minuta, dhe pastaj u ktheva përsëri në Barane nëpërmjes Irznicit. Me të mbërritur në Prapacan, ku e kish bazën Tahir **ZEMAJ**, mora një automjet për t'u kthyer në Barane.
95. Tahir **ZEMAJ** u largua nga Kosova në shtator me të gjithë oficerët dhe njerëzit e tij. Në fillim shkoi në malet e Rugovës dhe pastaj në Rozhajë dhe pastaj në Shqipëri. Unë qëndrova në Vranoc. Unë u largova drejt brigjeve të lumit Lumibardhë. Familja ime ishte në Isnic gjatë ofensivës së shtatorit. Me ndërhyrjen e OSBE-së, familja ime u kthye përsëri në Vrnaoc. Shtëpinë na i kishin djegur krejtësisht.
96. Ramush **HARADINAJ** ishte me Tahir **ZEMAJN** në Prapacan pas rënjes së Gllogjanit. Pastaj Ramush **HARADINAJ** shkoi në fshatin Brolic dhe që andej, shkoi në Jabllanicë.
97. Kjo është historia e konfliktit të armatosur në Zonën e Dukagjinit. Unë mora shumë shënime gjatë asaj kohe, por për fat të keq, të gjitha shënimet e mia u dogjën gjatë luftës. Shënimet ishin në zyrën time në shkollën fillore të Baranit.

Nënshkruar/inicialet:



25

të tjerë të pranishëm: nënshkrim





Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI

### Deklaratë

Më kanë informuar se deklarata ime mund t'u jepet agjencive të tjera të zbatimit të ligjit dhe/ose autoriteteve gjyqsore. Jam dakort që deklarata ime t'u jepet këtyre autoriteteve sipas gjykimit të Zyrës së Prokurorisë të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ish-Jugosllavinë.


### VËRTETIMI I DËSHMITARIT

Nënshkruar/inicialet:



26

të tjerë të pranishëm: nënshkrim



## Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI


Kjo deklaratë m'u lexua në gjuhën shqipe dhe është e vërtetë me sa di dhe sa më kujtohet. E kam dhënë këtë deklaratë me vullnet të lirë dhe e di se mund të përdoret gjatë procedurave ligjore para Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen e Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që nga 1991, dhe se mund të thirrem për të dhënë dëshmi publike para Gjykatës.

Nënshkruar: Data: 


## VËRTETIMI I PËRKTHYSES

Unë, Ardiana Sadiković, përkthyesë, vërtetoj se:

1. Jam e kualifikuar dhe e miratuar nga Sekretaria e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish- Jugosllavisë prej Vitit 1991, për të përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.
2. Më ka informuar Cufë **KRASNIQI** se e flet dhe kupton gjuhën shqipe.
3. Kam përkthyer me gojë deklaratën e mësipërme nga gjuha angleze në gjuhën shqipe në praninë e Cufë **KRASNIQIT**, i cili dukej se e ka dëgjuar dhe kuptuar përkthimin tim të kësaj deklarate.
4. Cufë **KRASNIQI** ka pranuar se faktet dhe çështjet e paraqitura në këtë deklaratë, siç i janë përkthyer prej meje, janë të vërteta me sa di dhe sa i kujtohet dhe rrjedhimisht ka nënshkruar në vendet përkatëse.

Nënshkruar/inicialet: 


27

të tjerë të pranishëm: nënshkrim 

Deklarata e dytë e dëshmitarit Cufë KRASNIQI

Nënshkrimi

Data 14 qershor 2007



Nënshkruar/inicialet



28

të tjerë të pranishëm: nënshkrim

